

Bashkia Durrës organizon Seminarin Shkencor në kuadër të Javës Evropiane të Lëvizshmërisë (16 - 22 Shtator 2019)

Bashkia Durrës edhe këtë vit do t'i bashkohet nismës JAVA EVROPIANE E LËVIZSHMËRISË, e cila zhvillohet nga data 16 deri më 22 Shtator 2019. Kjo Javë nxit bashkitë e qyteteve Evropiane (përfshirë qytetet nga Shqipëria) të prezantojnë dhe promovojnë ndërmarrjen e një sërë masave për të realizuar një transport sa më të qëndrueshëm duke ftuar të gjithë qytetarët që të përdorin alternativa të tjera për të lëvizur përveç përdorimit të mjeteve motorike.

Çdo edicion i JAVËS EVROPIANE TË LËVIZSHMËRISË fokusohet në një tematikë të veçantë lidhur me lëvizshmërinë dhe transportin e qëndrueshëm. Tema e këtij viti është: *“Ecje dhe pedalim i sigurtë/Safe walking and cycling”*, me moton: *Ecim së bashku/Walk with us!* Kjo tematikë vë në qendër të vëmendjes ecjen dhe pedalimin/çiklizmin e sigurt dhe përfitimet që mund të ketë ky i fundit për shëndetin dhe mjedisin tonë. Qytetet që promovojnë ecje dhe çiklizëm mbi automjete private gjithashtu janë zbuluar të jenë më tërheqëse, me më pak trafik të rënduar dhe me një cilësi më të lartë të jetës.

Kështu, në kuadër të promovimit të mënyrave alternative të lëvizshmërisë, Bashkia Durrës më datë 16.09.2019, në Sallën e Këshillit Bashkiak, ka organizuar një Seminar Shkencor me tematikë *“Walk with us Durrës”*, me të gjitha grupet e interesit apo aktorët lokalë që mbështesin lëvizshmërinë e qëndrueshme në qytet. Kështu, ky Seminar ka si qëllim prezantimin e Strategjisë së Lëvizshmërisë së Qëndrueshme, bazuar në një studim të kryer në kuadër të Projektit SUMPORT. Nëpërmjet prezantimit të kësaj Strategjie ofrohet mundësia për të paraqitur alternativa të qëndrueshme të lëvizjes për banorët lokalë dhe për të shpjeguar sfidat me të cilat përballen qyteti dhe qytetarët. Për më tepër, kjo Strategji ofron zgjidhje të qëndrueshme dhe inovative për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve si dhe për të kontribuar në atraktivitetin e qytetit për turistët.